



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:257698

Datë: 29.02.2024

Numri i dokumentit: 05423137

P.nr.1254/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL gjyqtari Refki Piraj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores Arbnijë Delijaj Gashi, në lëndën penale, kundër të akuzuarit I.M., nga Prizreni, rruga ‘.....’ pn, me numër personal, për shkak të veprës penale, Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokuroria Themelore Prizren PP/II. nr. 1770-9/23, të datës 24.11.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në praninë e Prokurorit të Shtetit Beqë Shala, të akuzuarit I.M., me datë 23.01.2024 mori, ndërsa përpiloj me datë 29.02. 2024 këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuarit:

I.M., nga i atidhe e ëma, i lindur me datënë Prizren, rruga ‘.....pn, i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, punëtor, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 22.09.2023, rreth orës 21:00min., në Prizren, në rr. “Ismet Jashari” saktësisht në oborrin e shkollës së mesme “Gjon Buzuku”, pas një kontrolli të zakonshëm të kryer nga policia, ku gjatë kontrollit fizik në çantën e të pandehurit i hasen substanca narkotike pa autorizim, të dyshuar me narkotikë të llojit “Marihuanë” me peshë të përgjithshme prej 0.48 gram (zero pikë katërdhjetë e tetë gram) dhe narkotik të llojit “Ekstazi” me peshë të përgjithshme prej 0.78 gram (zero pikë shtatëdhjetë e tetë gram), e vërtetuar edhe nga testi fushor M.M.C. International B.V. Cannabis Test, i datës 25.09.2023.

-Me këto veprime ka kryer veprën penale, Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të Kodit nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit **7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 43, 69, dhe nenit 269 par.2 të KPRK-së dhe nenet 242, 364 të KPPRK-së** të akuzuarit i shqipton :

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej dyqindedyzet (240) euro, të cilin dënim do ta paguaj në llogarinë e kësaj gjykate nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën në tërësi, gjykata mund të zëvendësoj pjesën e mbetur të gjobës me dënim me burgim, duke llogaritur 20 euro për 1 ditë burgim, gjegjësisht 12 ditë burgim.

- Gjykata në bazë të nenit Gjykata në kuptim të nenit 269 par.3 të KPRK-së, lidhur me nenin 274 dhe nenit 276 par.2 pika 2.4 të KPPRK-së:

Urdhëron- konfiskimin e dëshmive të sekuestruara përkohësisht :

- D#1 Substancë narkotike e llojit ‘‘Marihuanë’’, me peshë 0.48 gram dhe,
- D#2 Substancë narkotike e llojit ‘‘Ekstazi’’, me peshë 0.78 gram.

Këto dëshmi pas plotfuqishmërisë së këtij vendimi, duhet të shkatërrohet nga ana e Policisë së Kosovës-Stacioni Policor Prizren.

Obligohet i akuzuari që ti paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale në bazë të llogarisë së gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20,00 euro, dhe në emër të ligjit mbi mbrojtjen e viktimave të krimit shumën prej 20,00 euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren i ka paraqitur kësaj gjykate aktakuzën PP/II. nr. 1770-9/23, të datës 24.11.2023, ndaj të akuzuarit I.M., nga Prizreni, për shkak të veprës penale, Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Pas pranimit të shkresave të lëndës, gjyqtari i vetëm gjykues me datën 23.01.2024 ka caktuar shqyrtimin fillestar, fillimisht i akuzuari është udhëzuar nga gjyqtari i çështjes për të drejtat e tij të cilat i takojnë me ligj, të parapara në nenin 241 të KPPRK-së, ku i akuzuari pas udhëzimeve lidhur me të drejtat të cilat i takojnë sipas ligjit konform nenit 241 të KPPRK-së, pasi që ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, e ka pranuar fajësinë që i ngarkohet me aktakuzë.

Prokurori i Shtetit ka theksuar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

I akuzuari I.M., ka theksuar se e pranon fajësinë për veprën penale në tërësi.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 241 lidhur me 242 të KPPRK-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjykata konstatoi se i akuzuarit e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 244 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

Bazuar në pranimin e fajësisë nga i akuzuari dhe konform nenit 241 e 242 të KPPRK-së, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave.

Andaj kjo gjykatë duke u bazuar në këto që u thanë më lart vërtetohet gjendjen faktike se në veprimet e të akuzuarit I.M., plotësohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale, Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, prandaj dhe ia shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të neneve 69 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat lehtësuese si pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar, keqardhjen e shfaqur nga i akuzuari si dhe rrethanat personale se është i gjendjes së dobët ekonomike. Duke mos gjetur rrethanë rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 i KPRK-së dhe ky dënim si i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me peshën e veprës penale të kryer, me rrethanat personale dhe shkallen e përgjegjësisë të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, e mori në kuptim të nenit 449 dhe 451 të KPPK-së.

Vendimi mbi konfiskimin, e mori në kuptim të nenit 269 par.3 të KPRK-së, lidhur me nenin 274 dhe nenit 276 par.2 pika 2.4 të KPRK-së.

Më sa u tha më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi .

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL
P.nr.1254/2023 i datës 29.02.2024

G j y q t a r i

Refki Piraj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.